



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

### PROCESVERBAL <sup>1 2</sup>

(I përmbledhur)

Tiranë, më 03.02.2020, ora 14.30

**Drejtton mbledhjen**  
**Ardian Dvorani – Kryetar i Këshillit**

#### **Rendi i Ditës :**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.1, datë 08.02.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për miratimin e Rregullores së Brendshme për Funkcionimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”;

2. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për një shtesë në vendimin nr.2, datë 15.02.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”;

3. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;

4. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.5, datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”

5. Ngritjen e një grupi pune për hartimin e rregullores së brendshme lidhur me detyrat e këshilltarëve dhe personelit administrativ të Gjykatës së Lartë të caktuar për mbështetjen e veprimtarisë së Këshillit, për veprimet e ndryshme administrative, për krijimin dhe mbajtjen e regjistrave, dokumentacionit, protokollit, arkivave dhe për sistemin e administrimit të çështjeve, për të përmbushur angazhimin e deklaruar të KED-së 2019 në nenin 22 të Rregullores së Brendshme.

<sup>1</sup> Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226 pika 1 shkronja “d”, neni232 pika 2, neni 242 shkronja “c”) dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike diskutimet e vetë anëtarëve të KED për çështjen e rendit të ditës, natyra përmbledhëse e procesverbalit, imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED, disponon materialin e plotë audio dhe te zbardhur me shkrim të çdo mbledhje, sipas ligjit.

<sup>2</sup> Bashkëlidhur procesverbalit, për qëllime të njohjes nga kushdo i interesuar, gjenden projektvendimet me relacionet përkatëse të cilat janë në rendin e ditës së kësaj mbledhjeje.

### **Marrin pjesë :**

1. Ardian Dvorani (kryetar)
2. Vitore Tusha (zëvendës kryetare)
3. Fiona Papajorgji (anëtare)
4. Arta Marku (anëtare)
5. Miranda Andoni (anëtare)
6. Saida Dollani (anëtare)
7. Ludovik Dodaj (anëtar)
8. Fatjona Memçaj (anëtare)
9. Arjan Qafa (anëtar)
10. Marsida Xhaferllari (anëtare zëvendësues)
11. Bilbil Mete (anëtar zëvendësues)
12. Nazmi Troka (anëtare zëvendësuese)
13. Nezir Gjoka (anëtare zëvendësuese)

### **Merr pjesë, si vëzhgues i përhershëm :**

Avokati i Popullit, e përfaqësuar në këtë mbledhje nga znj. Nejla Peka, komisionere, e pajisur me autorizimin nr. 60 prot., datë 31.01.2020, lëshuar nga Avokati i Popullit.

### **Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguar në nenin 233/2 të ligjit nr.115/2016:**

1. Bledar Dervishaj dhe Katrin Treska, përfaqësues të Presidentit të Republikës, të pajisur me autorizimin nr. 446, datë 29.01.2020, lëshuar nga Presidenti i Republikës.

### **Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga institucionet ndërkombëtare, mbështetës me konsulencë në procesin e hartimit dhe miratimit të akteve nënligjore të KED :**

1. Agnes Bernhard, drejtuese e misionit EURALIUS;
2. Michelle Lakomy, këshilltare ligjore rezidente pranë OPDAT
3. Maniela Sota, përkthyes për EURALIUS
4. Xhoana Kovaçi, përkthyes për OPDAT

## HAPET MBLEDHJA - ora 14.40

**Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani**, deklaron të hapur mbledhjen.

Verifikohet prania dhe pjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit.

**Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani**, informon se anëtarja Fatjona Memçaj, për momentin nuk është e pranishme sepse vijon të jetë në gjykimin e një çështjeje penale dhe do të paraqitet menjëherë me mbarimin e asaj seance gjyqësore. Ndërkohë që anëtarët e tjerë të Këshillit si edhe anëtarët zëvendësues janë te pranishëm.

Gjithashtu, informohet Këshilli se është pranuar kërkesa e anëtares Fatjona Memçaj për heqjen dorë nga diskutimi dhe miratimi i projektakteve nënligjore normative të Këshillit, përveç projektaktit për ndryshime në Rregulloren e Brendshme, për shkak se në një nga vendet vakante që janë në shqyrtim është e kandiduar një i afërm i familjes së saj.

**Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani** lexon çështjet e rendit të ditës të njoftuar paraprakisht:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.1, datë 08.02.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për miratimin e Rregullores së Brendshme për Funkcionimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”;

2. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për një shtesë në vendimin nr.2, datë 15.02.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”;

3. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;

4. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.5, datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”

5. Ngritjen e një grupi pune për hartimin e rregullores së brendshme lidhur me detyrat e këshilltarëve dhe personelit administrativ të Gjykatës së Lartë të caktuar për mbështetjen e veprimtarisë së Këshillit, për veprimet e ndryshme administrative, për krijimin dhe mbajtjen e regjistrave, dokumentacionit, protokollit, arkivave dhe për sistemin e administrimit të çështjeve, për të përmbushur angazhimin e deklaruar të KED-së 2019 në nenin 22 të Rregullores së Brendshme.

Shtrohet për diskutim miratimi i rendit të ditës së paraqitur për këtë mbledhje të Këshillit.

**Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani** parashtron se përpara shqyrtimit të pikave të njoftuara të rendit të ditës, duhet të jetë e përfshirë në rendin e ditës si pikë e parë dhe të

shqyrtohet në fillim të mbledhjes edhe miratimi i procesverbalit të përmbledhur të mbledhjes së kaluar.

*Anëtarët e Këshillit* e miratojnë këtë rend dite.

*Këshilli*, si pikë të parë të rendit të ditës, shqyrton dhe miraton procesverbalin e përmbledhur të mbledhjes së KED të datën 15.01.2020.

*Paraqitet në mbledhje anëtarja e Këshillit, znj. Fatjona Memçaj.*

*Këshilli* vijon punimet e mbledhjes me pikën tjetër të rendit të ditës, me diskutimin dhe miratimin e projektvendimit “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.1 datë 08.02.2019 “Për miratimin e Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”.

*Marsida Xhaferllari*, në cilësinë e propozueses së projektvendimit, paraqet në mënyrë të përmbledhur mbi qëllimin dhe arsyet e ndërmarrjes së nismës për propozimin e këtij projektvendimi për shqyrtim dhe miratim nga Këshilli.

*Anëtarët e Këshillit* diskutojnë dhe vendosin të kalohet në diskutimin dhe miratimin nen për nen të dispozitave që propozohen në projektvendim.

*Marsida Xhaferllari*, në cilësinë e propozueses së projektvendimit, paraqet thelbin e motiveve për propozimin e dispozitës së nenit 1 të projektvendimit, për ndryshimin e shkronjës “c” dhe për shtesën e një shkronjë “e” në nenin 8, “Kompetencat e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”, të Rregullores së Brendshme për Funkcionimin e KED.

*Anëtarët e Këshillit* diskutojnë dhe shprehim mendimet e tyre në lidhje me përmbajtjen e nenit 1 të projektvendimit për ndryshime dhe shtesa në nenin 8 të Rregullores së Brendshme për Funkcionimin e KED.

*Nejla Peka*, merr fjalën dhe parashtron konsideratën për mënyrën sesi janë ndërtuar këto projektvendime nga pikëpamja e teknikës ligjvënëse, qoftë në formë edhe në përmbajtje. Sipas institucionit të Avokatit të Popullit, rregullat e organizimit dhe funksionimit të brendshëm të KED janë të nevojshme, aq më tepër kur ato kanë të bëjnë me marrjen e vendimeve për të tretët. Përsa i përket formulimit të shkronjës “c”, ndoshta afatin kohor i vendosur mund të mos jetë dy muaj, por një afat kohor duhet vendosur sepse çfarë do të ndodhë nëse asnjëri nga anëtarët nuk e shikon të arsyeshme, rast pas rasti, të kërkojë informacion nga kryetari i KED-së për çështjet që lidhen me organizimin, me mbështetjen financiare, administrative dhe me personel të Këshillit nga Gjykata e Lartë. Për sa i përket formulimit të shkronjës “e” nuk duket se shkelen rregullat e teknikës ligjvënëse. Vetë ligjvënësi ka gjykuar që për çështje të cilat janë të një natyre të veçantë dhe prekin të drejtat

themelore të individit, nëse i shkruajmë edhe njëherë në rregullore të brendshme, nuk shkelim ndonjë ligj.

**Bledar Dervishaj**, merr fjalën dhe parashtron se falënderon propozuesen e këtyre akteve, edhe Këshillin, edhe Kryetarin që e ka përfshirë në rend dite. Në themel të tyre katër projektvendimet rregullojnë problematika që ky Këshill ka hasur përgjatë gjithë vitit 2019. Në shumicën e tyre ato janë me tendencë përmirësuese dhe jam dakort me të gjitha propozimet për ti diskutuar. Gjatë diskutimit nen për nen, mund të kemi propozime shtesë për përmirësime të mundshme, detyrë të cilën e kemi bërë edhe përgjatë vitit të kaluar. Rregullorja e Brendshme është diskutuar gjatë vitin e kaluar se ku janë kufijtë e këtij rregullimi dhe sa Këshilli mund të interpretojë ligjin apo të jetë “mota mo” si ligji. Faktikisht, në formën se si i ka miratuar të katër aktet, Këshilli i ka përdorur të gjitha teknikat, qoftë përkufizim të njëjtë me atë që thotë ligji, qoftë ka dalë ndonjëherë dhe përtej ligjit apo në plotësim të ligjit. Kështu që, ripërsëritja e asaj që dikton ligji mund të pranohet në plotësim të aktit nënligjor. Për sa i takon shkronjës “c”, nuk mund të bëhet diskutimi a të pranohet apo jo në formën që është hartuar sepse mund të ketë vend për ta përmirësuar. Nëse duket si detyrim për kryetarin mund të rregullohet që çdo 3 muaj Këshilli informohet mbi ecurinë dhe problematikën administrative. Me të drejtë propozuesja, ashtu siç edhe ne e kemi konstatuar, edhe Avokati i Popullit e ka kërkuar, kemi 10 muaj që kërkojmë, nëse ka një problem që vjen nga mbështjetja administrative, le të jetë një rregull që çdo tre muaj Këshilli informohet mbi masat e marra apo nevojat e evidentuara. Po prapë Këshilli është ai që do të vendos çfarë do ti kërkojë Gjykatës së Lartë. Në dukje mund të duken probleme të vogla, por në 29-30 Dhjetor kur u diskutua raporti përmbledhës, ato problemet e vogla sollën ato pasojat e mëdha, të cilat kanë hasur debat dhe kundërshtim të lloj lloj karakteri në Këshill dhe në publik. Kështu që këto dy propozime i mbështes me ndonjë riformulim të mundshëm.

**Agnes Bernhard** (*përkthen përkthyesja*), duke falënderuar për ftesën për të qenë të pranishëm në diskutimin e rishikimit të këtij kuadri rregullator shprehet se është me të vërtetë kënaqësi që realizohet ky diskutim sepse çdo kuadër rregullator është i gjallë dhe ka nevojë të vazhdueshme për tu përshtatur e përmirësuar me zhvillimet dhe problematikat që janë hasur në të shkuarën. Në lidhje me propozimin për ndryshimin e nenit 8 nuk jemi në të vërtetë shumë të sigurt që ky propozim është i nevojshëm. Sikurse gjatë ndryshimeve që janë bërë në ligjet e sistemit të drejtësisë, Euraliusi nuk ka qenë pro idesë për të patur përsëritje të parashikimeve ligjore në aktet nënligjore sepse kjo ose sjell dublikime ose përsëritje ose në ndonjë divergjencë gjatë interpretimeve të tyre. Kjo vlen veçanërisht për propozimin për të shtuar shkronjën “e” tek neni 8. Ndërsa për sa i përket shkronjës “c”, mendojmë po ashtu se

kjo tashmë është e parashikuar brenda vetë Rregullores së Brendshme të Këshillit. Çdo herë që ka një propozim për të diskutuar Kryetari e parashikon në rendin e ditës. Pra ka mjete se si të bëhet ky trajtim në mënyrë të vazhdueshme. Po kështu, Këshilli është i angazhuar me procesin e verifikimit dhe vlerësimit të kandidatëve për anëtar të Gjykatës Kushtetuese dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe mund të ndodhë që për vite të mos mblidhet fare. Ndaj pse do të ishte e nevojshme që të parashikohet në mënyrë taksative që Këshilli të mblidhet çdo 2 muaj edhe kur mund të mos ishte fare e nevojshme për një periudhë të gjatë që Këshilli të ketë mbledhje, pra vetëm që të analizonte marrëdhëniet e veta me Gjykatën e Lartë. Jemi akoma në fazën e ndërtimit të Gjykatës Kushtetuese, ka akoma shumë vende vakante të hapura dhe është një proces i gjatë, por, si rregull, më pas mund të ketë nevojë për mbledhje edhe një herë në 3 vjet. Ky është thjesht një qëndrim për të konsideruar nëse duhet të përfshihet apo jo një parashikim i tillë.

**Michelle Lakomy** (*përkthen përkthyesja*), duke falënderuar për mundësinë që të jetë e pranishme për të diskutuar për ndryshimet e propozuara në Rregullore, parashtrohet se duke patur parasysh eksperiencën që kemi pasur deri tani, është e rëndësishme të shikojmë nëse ka nevojë për përmirësime gjatë procesit. Duke qenë se jam e fundit që po flas nuk doja të bija në përsëritje të atyre gjërave që u thanë. Do të doja të mbështesja argumentet që përmendi znj. Agnes dhe të tjerë që është më e mira të mos kemi përsëritje në rregullat e brendshme të cilat janë tashmë të parashikuara nga ligji. Edhe për sa i përket propozimit për ndryshim të nenit 8 shkronja "c", propozimi për tu mbledhur detyrimisht çdo dy muaj për çështjet e mbështetjes së Këshillit nga Gjykata e Lartë, duket ngarkesë e tepërt, ndërkohë që mund të jenë vite në të cilat nuk do të jetë e nevojshme të mblidhet Këshilli. Ka mekanizma të tjerë me anë të të cilëve anëtarët mund të sjellin në mbledhje e Këshillit diskutimin e kësaj çështjeje. Pra, për këto arsye mbase nuk është e nevojshme ta shtonim këtë parashikim të ri në këtë moment.

**Marsida Xhaferllari** merr fjalën dhe shprehet se kam vetëm një pyetje për ekspertet sepse këtu qëndrimin tim mbi teknikën legjislative e bëra me dije dhe nuk po kaloj në përsëritje. U tha këtu që këto rregulla janë të panevojshme sepse do të ndodhi në të ardhmen që KED-ja për tre vjet nuk do të ketë punë. Këtu kam një pyetje se si ka mundësi që ligji për qeverisjen, në nenin 226, pika 2, shkronja "ç", parashikon shprehimisht detyrimin e Kryetarit të KED-së që, njëherë në vit, të hartojë dhe të bëjë publik raportin vjetor mbi veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi? Faleminderit.

**Agnes Berhard** (*përkthen përkthyesja*), merr fjalën dhe përgjigjet se sigurisht e kuptova pyetjen që mu adresua. Mendimi im është se, sipas ligjit, sigurisht që Këshilli për

çdo vit duhet të përgatisë një raport vjetor dhe për atë vit kur nuk do të ketë asnjë lloj aktiviteti, do të parashtrahet në raportin vjetor vetëm se gjatë atij viti KED nuk ka pasur veprimtari për të ushtruar.

**Anëtarët e Këshillit**, në përfundim të diskutimeve, për propozimin e ndryshimit të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 8 të Rregullores së Brendshme për Funksonimin e KED, shprehën qëndrimin dhe votuan në këtë mënyrë: Për miratimin e propozimit votuan anëtarët **Arta Marku, Miranda Andoni dhe Arjan Qafa**. Për mosmiratimin e propozimit votuan anëtarët **Ardian Dvorani, Vitore Tusha, Fiona Papajorgji, Saida Dollani, Ludovik Dodaj, Fatjona Memçaj**. Me rezultatin e votimit 3 vota pro dhe 6 kundër, ky propozim nuk miratohet.

Për propozimin që të shtohet shkronja “e” pas shkronjës “dh” të pikës 1 të nenit 8 të Rregullores së Brendshme për Funksonimin e KED, **anëtarët e Këshillit** shprehën qëndrimin dhe votuan në këtë mënyrë: Për miratimin e propozimit votuan anëtarët **Arta Marku, Miranda Andoni, Arjan Qafa dhe Fatjona Memçaj**. Për mosmiratimin e propozimit votuan anëtarët **Ardian Dvorani, Vitore Tusha, Fiona Papajorgji, Saida Dollani dhe Ludovik Dodaj**. Me rezultatin e votimit 4 vota pro dhe 5 kundër, ky propozim nuk miratohet.

**Këshilli** vijon punimet me shqyrtimin dhe diskutimin në lidhje me përmbajtjen e nenit 2 të projektvendimit për një shtesë, si “pika 8”, në nenin 10 të Rregullores së Brendshme për Funksonimin e KED.

**Marsida Xhaferllari**, në cilësinë e propozueses së projektvendimit, parashtron se duke qenë se ka të njëjtën përmbajtje me nenin 4 të projektvendimit që do të shqyrtohet më pas, e tërheq propozimin e dispozitës së nenit 2 të projektvendimit, për të shtuar një pikë, si “pika 8” në nenin 10, “Thirrja dhe kohëzgjatja e mbledhjeve të Këshillit”, të Rregullores së Brendshme për Funksonimin e KED.

**Këshilli** vijon punimet me shqyrtimin dhe diskutimin në lidhje me përmbajtjen e nenit 3 të projektvendimit për disa shtesa në pikat 1, 9 dhe 10 të nenit 11 të Rregullores së Brendshme për Funksonimin e KED.

**Marsida Xhaferllari**, në cilësinë e propozueses së projektvendimit, paraqet thelbin e motiveve për propozimin e dispozitës së nenit 3 të projektvendimit, për disa shtesa në pikat 1, 9 dhe 10 të nenit 11, “Njoftimet për thirrjen e mbledhjes”, të Rregullores së Brendshme për Funksonimin e KED. Gjithashtu, në kushtet kur në këtë mbledhje të sotme pati një diskutim mbi nenin 8, pika 1, shkronja “c” e cila konvertohet si kompetencë e kryetarit, propozoj në këtë moment që, në nenin 11 të shtohet që kur Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka aktivitet vjetor, pra është i mbledhur, një herë në 3 muaj dhe në çdo rast që konstatohen vonesa

administrative, kërkon informacion. Kryetari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi informon anëtarët mbi masat e marra për mbështetjen organizative, financiare dhe administrative si dhe iniciativën mbi numrin e vazhdueshëm të punonjësve administrativë të Gjykatës së Lartë. Pra, për të bërë atë votimin që kishte një alternativë të tretë në propozimin e atij neni.

**Anëtarët e Këshillit** diskutojnë dhe shprehim mendimet e tyre në lidhje me përmbajtjen e nenit 3 të projektvendimit për disa shtesa në pikat 1, 9 dhe 10 të nenit 11 të Rregullores së Brendshme për Funksionimin e KED.

**Nejla Peka**, merr fjalën dhe parashtron se propozimi është një shtjellim më i hollësishëm lidhur me dërgimin e materialeve, jo vetëm tek anëtarët e KED-së, por edhe tek ata që janë subjekte me cilësinë e të ftuarve dhe aq më tepër edhe me një cilësi të posaçme të vëzhguesit dhe monitoruesit të një procesi që, në gjykimin tonë, duhet të jetë sa më transparent. Besoj se vendosja e afatit 48 orë, ashtu sikurse e theksoi edhe propozuesja e dispozitës, në fakt është një afat që është i vendosur për analogji edhe në funksionimin e organeve të tjera të ngjashme për mënyrën sesi zhvillojnë mbledhjet, njoftimin dhe rendin e ditës dhe dërgimin e materialeve. Reformulimi është plotësisht i nevojshëm dhe një vlerë e shtuar për ta shtjelluar më në detaje se çfarë ndodh, aq më tepër kur kemi të bëjmë me vendimmarrje për çështje të rendit të ditës që burojnë nga informacione të dërguara nga institucione të treta në procesin e vlerësimit të kandidaturave e që janë baza kryesore e furnizimit të vendimmarrjes KED-së për rastin e kandidatëve që vijnë nga jashtë sistemit.

**Bledar Dervishaj**, merr fjalën dhe parashtron se të paktën tek pika 1 nuk shikoj ndonjë problematikë, pasi në paragrafin e dytë siç është aktualisht pika 1 e nenit 11, thirrja dhe njoftimi i mbledhjes bëhet dhe përpara këtij afati, pra përpara 5 ditëve. Ka ndodhur që është bërë 24 orë përpara. Por unë do ta shikoja pak jo me problematikën që ka krijuar me anëtarët e Këshillit, më shumë me Avokatin e Popullit që ka pasur problematikë me administrimin e dokumentacionit dhe njohjes me të. Anëtarët e Këshillit njihen, dikush është relator ose bashkërelator, ata njihen me dokumentacionin voluminoz, prezumohen se janë njojtur më parë Ndërsa Avokati Popullit e merr rishtazi dhe do ti duhet që për 24 orë apo ndoshta më shpejt, siç do ta kërkonte urgjenca, të njihet me mbi 400, 500 faqe. Apo afektimi që kjo dispozitë mund të ketë për njoftimet e subjekteve që i nënshtrohen verifikimit dhe vlerësimit. Edhe atyre ju dërgohet relacion. Ka pasur edhe proces gjyqësor që është konstatuar që nuk është njoftuar fare relacioni. Duhet parë a lidhet kjo dispozitë me këtë rregull dhe detyrim përkundrejt subjektit që verifikohet. Kështu që afati që i propozuar 48 orë është më se i pranueshëm dhe nuk besoj që do të ketë ndonjë urgjencë kaq të madhe sa ky afat mos të respektohet.



**Agnes Berhard** (*përkthen përkthyesja*), merr fjalën dhe shprehet se në interpretim të nenin 11 pika 1 i takon Këshillit ose me saktë kryetarit të thërrasë mbledhjen 5 ditë më përpara, së bashku me axhendën dhe materialet e tjera. Kjo është ndryshe nga parashikimi i ligjit për organet kolegjiale ku parashikohet vetëm njoftimi i rendit të ditës 48 orë përpara mbledhjes. Ndaj interpretimi i fjalisë së parë të dispozitës që propozohet duket sikur do të ulë standardin sepse në vend që të kemi afat 5 ditor paraprak, i bie të kemi afat 48 orë paraprak. Ndërsa fjalia e dytë është propozim për situatën kur ka disa dokumente që vijnë nga institucionet e treta që dorëzohen në minutën e fundit. Pra për ta nisur nga fundi, do ta lija në diskrecionin e Këshillit për ta pranuar dhe diskutuar, rast pas rasti, në atë mbledhje apo për ta shtyrë për më vonë këtë çështjen e materialeve, duke pasur parasysh ligjin për organeve e qeverisjes dhe gjithashtu ligjin për organet kolegjiale ku nuk parashikohet diçka të tillë. Kjo sepse mund të jetë rasti i një situate që mund të ketë një ndryshim apo një diskutim prej një fjalie të vetme dhe ajo fjali paraqitet gjatë takimit dhe përpunohet në atë takim. Por mund të jetë dhe një material voluminoz dhe për këtë gjë do të duhet një shtyrje e mbledhjes ose do të duhet një përgatitje paraprake përpara se të bëhet një diskutim apo merret vendim dhe për rrjedhojë do të ketë edhe shtyrje të mbledhjes në një datë tjetër.

**Michelle Lakomy** (*përkthen përkthyesja*), merr fjalën dhe parashtrohet se nuk mendon të shtojë ndonjë gjë tjetër dhe dakordësohet me komentet që bëri zonja Agnes.

**Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani**, pas këshillimit me pjesëmarrësit, për shkak edhe të nevojave të teknikës së regjistrimit audio të punimeve të mbledhjes, cakton 10 minuta pushim.

## **PJESA E DYTË E MBLEDHJES**

**Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani**, orienton vijimin e diskutimit të deritanishëm në lidhje me përmbajtjen e nenit 3 të projektvendimit për disa shtesa në pikat 1, 9 dhe 10 të nenit 11 të Rregullores së Brendshme për Funkcionimin e KED, duke ftuar anëtarët e Këshillit nëse kanë diskutim tjetër për shtesën e propozuar në pikën 1 të nenit 11 të kësaj Rregulloreje.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë diskutime të tjera për shtesën e propozuar në pikën 1 të nenit 11 të Rregullores së Brendshme për Funkcionimin e KED.

**Bledar Dervishaj**, merr fjalën dhe parashtrohet se duke parë edhe diskutimin e të gjithë anëtarëve të Këshillit dhe të ekspertëve të pranishëm, është e mundur që në formulimin aktual siç e ka pika 1 e nenit 11, pas fjalisë së parë të bëhet shtesa e propozuar ose të paktën fjalia e parë që është propozuar. Pra në çdo rast njoftimi dhe dërgimi i matërialeve duhet bërë të paktën 48 orë përpara zhvillimit të mbledhjes dhe pas kësaj fjalia të jetë siç vazhdon këtu në

pikën 1, duke bërë një saktësim që në rastet e urgjencës dhe arsye të justifikuar edhe përtej këtij afati, por gjithmonë duhet të jetë kërkesa e justifikuar. Janë jo të pakta rastet kur organet kolegjiale mbledhen edhe brenda ditës. Raste urgjente patjetër që ka, por duhet të jetë e justifikuar që thirrja e mbledhjes për këtë çështje bëhet pikërisht për këtë arsye. Pra, si rregull është 5 ditë, por gjithmonë jo më përpara se 48 orë dhe vetëm në raste ekstreme të justifikuar mund të bëhet edhe brenda ditës. Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka pasur çështje që bëheshin mbledhje edhe brenda ditës kur kërkohej pezullim gjyqtarësh apo mbledhje të jashtëzakonshme.

**Anëtarët e Këshillit**, në përfundim të diskutimeve, për propozimin e shtesës së dy fjalive në pikën 1 të nenit 11 të Rregullores së Brendshme për Funkcionimin e KED, shprehën qëndrimin dhe votuan në këtë mënyrë: Për pranimin vetëm pjesërisht të propozimit, pra vetëm të fjalisë së dytë të shtesës në pikën 1 votoj anëtarja e Këshillit **Miranda Andoni**. Për mospranimin e propozimit votuan anëtarët **Ardian Dvorani, Vitore Tusha, Fiona Papajorgji, Arta Marku, Saida Dollani, Ludovik Dodaj, Fatjona Memçaj dhe Arjan Qafa**. Me rezultatin e votimit 1 votë pro dhe 8 kundër, ky propozim nuk miratohet.

**Këshilli** vijon punimet me shqyrtimin dhe diskutimin në lidhje me përmbajtjen e nenit 3 të projektvendimit për disa shtesa e propozuara në pikat 9 dhe 10 të nenit 11 të Rregullores së Brendshme për Funkcionimin e KED.

**Anëtarët e Këshillit**, diskutojnë dhe parashtrojnë argumentet e tyre në lidhje me dy shtesa e propozuara, përkatësisht në pikat 9 dhe 10 të nenit 11 të Rregullores së Brendshme për Funkcionimin e KED.

**Nejla Peka**, merr fjalën dhe parashtron se i gjejmë me vend të dyja propozimet. Jemi dakort me atë që thotë se mund të mos qëndrojmë në pikën 9, por mund të jetë pikë më vete 8/1, nëse qëndron teknikisht. Është shumë qartësisht e shprehur për pikat 5 dhe 8, zëvendës kryetari kryen të njëjtat veprime proceduriale si kryetari. Dhe pastaj për afatet e njëjtja edhe për Avokatin e Popullit normalisht jemi shumë dakort.

**Bledar Dervishaj** merr fjalën dhe parashtron se asgjë e keqe nuk vjen nga saktësimi. Asnjë paragraf nuk e konsiderojmë të tepërt kur ai saktëson procesin se si veprojnë organet për të realizuar atë që është qëllim i ligjshëm. Kështu që teknikisht të jetë 8/1 sipas atij propozimit jo tek pika 9, ndërsa pika 10 siç propozohet, jemi dakord.

**Michelle Lakomy** (përkthen përkthyesja), merr fjalën dhe parashtron se e kuptoj konceptin por vetëm kam një pyetje. A nuk është e parashikuar tek neni 19 pika 3 që parashikon se në rast se ka pengesa ligjore apo situata të caktuara ndaj kryetarit atëherë është zëvendëskryetari ai që e zëvendëson atë, në rastin e pengesave ligjore?

**Marsida Xhaferllari** merr fjalën dhe përgjigjet se ideja është që neni 19 pika 3 përdor frazën “*këto funksione*”. Pra bëhet fjalë për funksionet e listuara në nenin 19 dhe jo për këtë funksion specifik që rregullohet nga neni 11. Megjithatë, siç u tha këtu në mbledhje, ka ndodhur një situatë e ngjashme dhe Këshilli i ka dhënë zgjidhje. Kjo është thjesht për saktësim.

**Agnes Bernhard** (*përkthen përkthyesja*), merr fjalën dhe shprehet se nuk ka asgjë për të shtuar.

**Anëtarët e Këshillit**, në përfundim të diskutimeve, për propozimin e shtesës së një fjalie në pikën 9 të nenit 11 të Rregullores së Brendshme për Funkcionimin e KED, shprehën qëndrimin dhe votuan në këtë mënyrë: Për miratimin e propozimit votuan anëtarët **Miranda Andoni** dhe **Fatjona Memçaj**. Për mosmiratimin e propozimit votuan anëtarët **Ardian Dvorani**, **Vitore Tusha**, **Fiona Papajorgji**, **Arta Marku**, **Saida Dollani**, **Ludovik Dodaj** dhe **Arjan Qafa**. Me rezultatin e votimit 2 vota pro dhe 7 kundër, ky propozim nuk miratohet.

**Anëtarët e Këshillit**, në përfundim të diskutimeve, për propozimin e shtesës së disa fjalëve në pikën 10 të nenit 11 të Rregullores së Brendshme, shprehën qëndrimin dhe votuan në këtë mënyrë: Për miratimin e propozimit **votuan të gjithë anëtarët e Këshillit**.

**Këshilli** vijon punimet me shqyrtimin dhe diskutimin në lidhje me përmbajtjen e nenit 4 të projektvendimit për disa shtesa dhe ndryshime të propozuara në pikat 4 dhe 12 të nenit 16 “Punimet e mbledhjes së Këshillit”, të Rregullores së Brendshme për Funkcionimin e KED.

**Marsida Xhaferllari**, në cilësinë e propozueses së projektvendimit, paraqet thelbin e motiveve për propozimin e dispozitës së nenit 4 të projektvendimit, për disa shtesa dhe ndryshime të propozuara në pikat 4 dhe 12 të nenit 16 “Punimet e mbledhjes së Këshillit”, të Rregullores së Brendshme për Funkcionimin e KED.

**Anëtarët e Këshillit**, diskutojnë dhe parashtrojnë argumentet e tyre në lidhje me propozimet e paraqitura për shtesa dhe ndryshime në pikat 4 dhe 12 të nenit 16 të Rregullores së Brendshme për Funkcionimin e KED.

**Nejla Peka**, merr fjalën dhe parashtron se nevojitet paraprakisht të bëjë një sqarim dhe më pas të shpreh gjykimin si përfaqësuese e institucionit të Avokatit të Popullit. Unë nuk kam qenë në mbledhje kur është diskutuar, sikundër nuk mund të mar për bazë atë çka mund të këtë shprehur Avokatja e Popullit në qëndrimin e saj kur keni diskutuar draftregulloren në krye të herës sa i përket mënyrës së votimeve. Nëse me lejoni të shpreh këtu një gjykim personal si juriste dhe për ti qëndruar strikt asaj çka ligji nr.115/2016 për organet e qeverisjes ka paraparë në nenin 229, konkretisht pika 1, ku thotë se KED funksionon si organ kolegjal

bazuar në rregullat dhe procedurat e parashikuar në këtë Kre dhe për aq sa është e mundur të plotësohen me ato që ka ligji nr.8480/1999, jam dakord me të dyja propozimet përpos faktit që edhe me votimin e kryetarit qoftë i pari apo i fundit ky votim do të ishte përcaktues dhe do të diktonte qasjen e anëtarëve të KED. Por për ti qëndruar parashikimeve ligjore korrekt mendoj se duhet të jemi në të njëjtën linjë siç e ka parashikuar ligji për organet kolegjiale.

**Bledar Dervishaj** merr fjalën dhe parashtron se kujtoj diçka nga diskutimi dhe shikova pak arkivën elektronike për të parë si është propozuar drafti, cilat ishin ndryshimet e propozuara. Në shkurt kanë qenë dy drafte paralel me propozime dhe sikur ato të miratoheshin 100%, në mbledhjen e fundit duhet të ketë ndryshuar kjo lloj qasje se gjithmonë ka qenë që në rast se nuk është relator, voton gjithmonë i fundit dhe kjo është një linjë që orientohet nga vetë ligji për organet kolegjiale. Te dyja propozimet janë objektive. Gjithmonë kuorumet e larta tërheqin konsensus dhe diskutim të gjerë, kërkojnë dhe japin garanci më shumë se sa kuorumet e ulta. Ndërsa sa i takon votimit të kryetarit i fundit jo vetëm që shkon paralel me qëllimin e ligjit për organet kolegjiale por ka dhe një të dhënë historike që ne duhet ta kujtojmë. Vota dominuese e kryetarit ka bërë që të ndryshojë një rregull i rëndësishëm që ka krijuar një konflikt gjyqësor sot: padinë e Avokatit të Popullit. Pra në këtë rregullore që po shqyrtojmë sot lejohet prezenca e Avokatit të Popullit në mbledhjet e Këshillit e në të gjithë veprimtarinë dhe është e votuar 4 me 3. Ndërsa në dy aktet e tjera me nr.4 dhe nr.5 ky rregull është përmbysur me vota të barabarta me votën 3 me 3 dhe kryetari ka dominuar. Prandaj duhet të votoj i fundit duke mos ndikuar qoftë emocionalisht. Duket sikur kryetari tërheq grupin e Këshillit, në pamjen e parë jo në atë faktike. Kryetari ka gjithmonë një peshë më të madhe. Kështu që më mirë të qëndroj gjithmonë në heshtje deri sa të shprehen të gjithë dhe të jetë ai i fundit për tu shprehur. I mbështes të dy propozimet.

**Agnes Berhard** (përkthen përkthyesja), merr fjalën dhe shprehet se sikurse e kam tshprehur edhe në mendimet e mëparshme, mendoj se duhet të tërheqë vëmendjen dhe të jemi të kujdesshëm për të qenë në pajtim me kuadrin rregullator të ligjit e që në këtë rast është ligji për organet kolegjiale. Nuk kam asnjë gjë tjetër për të shtuar dhe nuk kam asnjë kundërshtim në raport me sa u tha deri tani.

**Anëtarët e Këshillit**, në përfundim të diskutimeve, për propozimin e ndryshimit të fjalisë së dytë të pikës 4 të nenit 16 të Rregullores së Brendshme për Funkcionimin e KED, shprehën qëndrimin dhe votuan në këtë mënyrë: Për miratimin e propozimit votuan anëtarët **Ardian Dvorani, Vitore Tusha, Arta Marku, Miranda Andoni, Saida Dollani, Ludovik Dodaj, Fatjona Memçaj dhe Arjan Qafa**. Për mosmiratimin e propozimit votoi anëtarja **Fiona Papajorigji**. Me rezultatin e votimit 8 vota pro dhe 1 kundër, ky propozim miratohet.

**Anëtarët e Këshillit**, në përfundim të diskutimeve, për propozimin e ndryshimit të pikës 12 të nenit 16 të Rregullores së Brendshme për Funksonimin e KED, shprehën qëndrimin dhe votuan në këtë mënyrë: Për miratimin e propozimit votuan anëtarët **Ardian Dvorani, Saida Dollani, Fatjona Memçaj dhe Arjan Qafa**. Për mosmiratimin e propozimit votuan anëtarët **Vitore Tusha, Fiona Papajorigji, Arta Marku, Miranda Andoni dhe Ludovik Dodaj**. Me rezultatin e votimit 4 vota pro dhe 5 kundër, ky propozim nuk miratohet.

**Këshilli** vijon punimet me shqyrtimin dhe diskutimin në lidhje me përmbajtjen e nenit 5 të projektvendimit për ndryshime të propozuara në titull dhe në pikën 6, si edhe për një pikë shtesë pas pikës 8 të nenit 17, “Përmbledhja e procesverbalit”, të Rregullores së Brendshme për Funksonimin e KED.

**Marsida Xhaferllari**, në cilësinë e propozueses së projektvendimit, paraqet thelbin e motiveve për propozimin e dispozitës së nenit 5 të projektvendimit, për ndryshime të propozuara në titull dhe në pikën 6, si edhe për një pikë shtesë pas pikës 8 të nenit 17, “Përmbledhja e procesverbalit”, të Rregullores së Brendshme për Funksonimin e KED.

**Anëtarët e Këshillit**, diskutojnë dhe parashtrojnë argumentet e tyre në lidhje me propozimet e paraqitura për disa ndryshime në titull dhe në pikën 6 dhe shtesën e një pike pas pikës 8 të nenit 17 të Rregullores së Brendshme për Funksonimin e KED.

**Nejla Peka**, merr fjalën dhe parashtron me ndryshimet e propozuara në këtë nen, për sa i përket mënyrës se si administrohet dhe procedohet me vendimmarrjen në Këshill, institucioni i Avokati të Popullit është tërësisht dakord. Kjo është një nga problematikat që ne e kemi pasur në fakt për të dalluar çfarë nënkupton procesverbal i përmbledhur ose përmbledhje procesverbali dhe çfarë do të thotë të kesh një procesverbal të zbardhur të gjithë vendimmarrjes së Këshillit. Jemi tërësisht dakort dhe nga pikëpamja e teknikës ligjvënëse. Nuk ka rëndësi se shtohet një pikë 9 apo kjo i bashkëngjitet pikës 8. Është vlerë e shtuar ta kemi dhe për sa kohë ligji e përcakton të bëhet një zbardhje e procesverbalit nga regjistrimi audio, kjo është në vetvete ajo që kërkohet. Pra përveç procesverbalit të përmbledhur ne të kemi dijeni, të marrin informacion për çfarë është diskutuar në detaje sipas regjistrimit audio. Ne këtë e kërkojmë të transkriptuar, të zbardhur.

**Bledar Dervishaj** merr fjalën dhe parashtron se duke u mbështetur në logjikën e parashtruar nga Avokati i Popullit, gjithmonë, gjatë vitit të kaluar dhe tani në seancë, kemi qenë të idesë që mbledhjet e Këshillit të dokumentohen dhe informacioni që jepet nga zbardhja e këtyre bisedave të konsumohet nga disa palë. Nga konsumatori publik është ajo që merret nga deklaratat për shtyp dhe procesverbali i përmbledhur. Por aty, po të shikosh formatin e procesverbalit të përmbledhur, duket sikur mbledhjen e zhvillojmë unë dhe

Avokati i Popullit, sepse fjala jonë është më e pakufizuar, ndërkohë që për Këshillin ka ndonjë fjali aty dhe nuk kuptohet cili është diskutimi i Këshillit. Kështu që kjo e bën të domosdoshme që Këshilli të njihet edhe vetë herë pas herë me çfarë ka diskutuar në mbledhjet më parë. Do ishte më praktike të vendoste kufjet apo do ishte më praktike ta lexonte të zbardhur. Normalisht kjo e dyta është më e mirë. Transkripti është garancia e asaj që zbardhet në letër e që duhet miratuar në mbledhjen që vjen, bashkë me përmbledhjen. Me pak rregullime të teknikës, të dyja propozimet jam dakord që të pranohen.

**Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani** merr fjalën dhe sqaron se përpara se të kalojmë tek qëndrimet e anëtarëve të Këshillit, duhet sqaruar se të gjitha procesverbalet janë të transkriptuara. Pra, përveç regjistrimit audio, ne i kemi të gjitha mbledhjet të transkriptuara të plota, fillim - mbarim, sepse ky ka qenë dhe interpretimi jonë i pikës 8. Kjo edhe pse nuk kishte ndonjë kusht ligjor për të bërë ose jo transkriptimin e plotë, ne e kemi bërë të plotë për të 39 mbledhjet e Këshillit. Kjo është më shumë për të sqaruar edhe se për çfarë do të votojmë dhe çfarë kërkohet që të ndryshojmë.

**Bledar Dervishaj** merr fjalën dhe parashtron se jam dakort por ishte ideja që të ishte edhe në transkript. Këtë dëgjova nga një anëtar i Këshillit. Dhe tjetra është që kemi bërë një debat të vazhduar Avokat Populli dhe President i Republikës me Këshillin e mëparshëm, me këtë Këshill akoma se kemi filluar këtë debat, për të marrë kopjen e procesverbalit të zbardhur si persona të ftuar. Ndërkohë që njihemi me gjithçka, kopjen e procesverbalit të plotë nuk e marrim dot.

**Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani** merr fjalën dhe sqaron se ky është një diskutim tjetër.....

**Nejla Peka**, ndërhyr dhe parashtron se ndërkohë dhe e drejta e Avokatit të Popullit që e merr kur e kërkon, nuk ka qenë më parë.

**Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani** merr fjalën dhe sqaron se kam thënë gjithmonë dëgjoheni dhe lexojeni këtu, por jashtë selisë nuk mund të dalin sepse ne kemi një kufizim e detyrim aty që na e vendos qartë ligji, pra që diskutimet tona nuk bëhen publike dhe askush nuk e garanton më n.q.s materiali del nga ....

**Saida Dollani**, ndërhyr dhe sqaron se prandaj ligji nuk e parashikon si transkript, por parashikon vetëm procesverbalin e përmbledhur. Po të ishte e parashikonte ligji, siç e ka parashikuar edhe në procedure civile dhe në procedurën penale, madje me kërkesë të palëve thotë procedura. Ndërsa këtu përderisa thotë mbledhja është e mbyllur, nuk duhet bërë publike. Me motivin e kërkesës së marrjes së transkriptit sipas drejtës për informim dhe pasi e merr transkriptin dhe bëhet publike e del çfarë ka thënë anëtari, atëherë?!...

*Nejla Peka*, ndërhyt dhe parashtron se në këtë rast nuk gjykoheft për Avokatin e Popullit, sepse cilësia e tij, e të qënit si subjekt i ftuar me një karakteristike të posaçme si institucion kombëtar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ai është vëzhgues dhe monitorues dhe këtë nuk e ka do kushdo, besoj se nuk është ky rasti që e nxjerr apo keqtrajton procesverbalin....

*Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani* merr fjalën dhe shprehet se ne po sqarojmë vetëm që edhe anëtari vetë nuk e merr dhe e nxjerr jashtë KED, jo më Avokati i Popullit dhe të tjerë. Nuk po bëhen përjashtime për të tjerët dhe po e marrin vetë anëtarët. Duam të mbrojmë atë që është e parashikuar qartë në ligj dhe mënyrë më të mirë dhe më të sigurt se sa kjo nuk ka.

*Bledar Dervishaj* merr fjalën dhe parashtron se ka një komunikim shkresor të Presidentit të Republikës me Këshillin, me Kryetarin, për dhënien e procesverbalit dhe kjo është e vërtetë. Ka një refuzim për të dhënë një kopje të transkriptit të zbardhur apo CD. Në rast se Presidenti i Republikës kërkon të njihet me transkriptin, kjo është një e drejtë kushtetuese që nuk ia mohon dot njëri. Është dokument dhe e ka kërkuar. Si mund ta refuzojë? Unë habitem sinqerisht sepse ligji thotë se mbledhjet janë të mbyllura, por nuk janë të mbyllura për mua që jam këtu. Unë dëgjoj gjithçka që thuhet dhe nëse dua ta bëj publike dal aty dhe e bëj publike dhe nuk jam autoritet që të mund të vihet në dyshim se mund të shpërndaj informacionin që e marr këtu apo aq më keq ta keqpërdor. Në këtë sens vjen ky propozim. A mund ta marr një kopje të transkriptit? Sepse ne diskutojmë, flasim, komentojmë, për aq sa na lejohet deri sa të bëjmë aktet nënligjore pasi kur të hyjmë në verifikim e vlerësim është Avoakti i Popullit me të drejte kushtetuese që do të shprehë mendime. Por që të refuzohet Presidenti, Kryetari i Kuvendit, pasi e kërkon regjistrimin audio se ka nevojë të njihet me themelin e çështjes që diskutoam, më duket pak si shumë kufizuese dhe përtej asaj që thotë ligji. Ligji e ka për publikun e gjërë. Publikut i jepet në mënyrë të përmbledhur. E lexon komunikatën bashkë me procesverbalin e përmbledhur që miratohet. Por për institucionet që janë prezent këtu? Prandaj do të kërkoj edhe një herë rivlerësimin e Këshillit për këtë çështje. Është vërtet serioze.

*Anëtarët e Këshillit*, në përfundim të diskutimeve, për propozimin e ndryshimit të titullit të nenit 17 të Rregullores së Brendshme për Funksionimin e KED, shprehën qëndrimin dhe votuan në këtë mënyrë: Për miratimin e propozimit votuan anëtarët *Ardian Dvorani, Vitore Tusha, Fiona Papajorigji, Arta Marku, Miranda Andoni, Ludovik Dodaj, Fatjona Memçaj dhe Arjan Qafa*. Për mosmiratimin e propozimit votoi anëtarja *Saida Dollani*. Me rezultatin e votimit 8 vota pro dhe 1 kundër, ky propozim miratohet.

*Anëtarët e Këshillit*, në përfundim të diskutimeve, për propozimin e ndryshimit të pikës 6 të nenit 17 të Rregullores së Brendshme, shprehën qëndrimin dhe votuan në këtë mënyrë: Për miratimin e propozimit votuan anëtarët *Ardian Dvorani, Vitore Tusha, Fiona Papajorigji, Arta Marku, Miranda Andoni* dhe *Arjan Qafa*. Për mosmiratimin e propozimit votuan anëtarët *Saida Dollani, Ludovik Dodaj* dhe *Fatjona Memçaj*. Me rezultatin e votimit 6 vota pro dhe 3 kundër, ky propozim miratohet.

*Anëtarët e Këshillit*, në përfundim të diskutimeve, për propozimin e shtesës së një “pikë 9” pas pikës 8 të nenit 17 të Rregullores së Brendshme, shprehën qëndrimin dhe votuan në këtë mënyrë: Për miratimin e propozimit votoi anëtari *Arjan Qafa*. Për mosmiratimin e propozimit votuan anëtarët *Ardian Dvorani, Vitore Tusha, Fiona Papajorigji, Arta Marku, Miranda Andoni, Saida Dollani, Ludovik Dodaj* dhe *Fatjona Memçaj*. Me rezultatin e votimit 1 votë pro dhe 8 kundër, ky propozim nuk miratohet.

*Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani*, pas marrjes së mendimit të pjesëmarrësve në mbledhje, me dakordësinë e anëtarëve të Këshillit, deklaroi të mbyllur mbledhjen dhe caktimin e mbledhjes së rradhës në datën 05.02.2020, në orën 14.00, për të vijuar punimet me të njëjtin rend dite.

#### **MBYLLET MBLEDHJA NË ORËN 18.50**

#### **SEKRETARE**

**Vilma DOKUSHI**

**Elona KARDHIQI**

**Ermelinda KADIU**

**Dorina DULAJ**

**Fabjola MUHAMETI**

#### **KRYETAR**

**Ardian DVORANI**